

V E N D I M
PER REGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK

Sot me daten 29.10.2003 une Marjana Dedi me detyren e gjyqtares prane gjykates shkalles pare Tirane mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga kerkuesi ;Haxhi Kreku administrator I shoqerise ALION shpk per regjistrimin si person juridik te shoqerise me pergjegjsi te kufizuar si me siper dhe :

Konstatova se :

Kerkuesi Haxhi Kreku me vullnetin e tij te lire ka formuar shoqerinse me pergjegjsi te kufizuar te cilet e ka emrtuar ALION shpk.Per ushtrimin e veprimtarise siperme ai ka hartuar kontraten e themelimit te shoqerise dhe statutin e saj,ka paguar prane bankes kursimeve Berat kapitalin themeltar te shoqerise prej 100 000 leke.

Objekti veprimtarise se shoqerise do te jete :Shfrytezimi dhe perpunimi I meneraleve te grupit te katert sipas lgjit minerar si gur dekorativ,gur gelqeror,materjale interte etj,tregetim me shumice e import ekspert te mallrave te ndryshem industriale dhebujqesor.Transport kombetar dhe nderkombetar te mallrave per vehte dhe per te trete.Sherbime ne fushen e ndertimit si rikonstruksione e ndertime objekte social kulturore e banesa.

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise eshte pa afat.

Selia e shoqeriseeshte nelagjen 30 vjetori Berat.

Administratori I saj eshte vet themeluesi Haxhi Kreku.

Ne kushtet si me siper kerkesa eshte edrejte dhe duhet pranuar.

Per keto arsye

Ne baze te ligjes 7638 date 19.11.19992dhe ligjes 7667 date 28.1.1993

V E N D O S A

Pranimin e kerkeses.

Regjistrimin si person juridik te shoqerise me pergjegjsi te kufizuar ALION shpk.

Objekti I veprimtarise se shoqerise eshte

Shfrytezimi dhe perpunimi I meneraleve te grupit te katert sipas lgjit minerar si gur dekorativ,gur gelqeror,materjale interte etj,tregetim me

shumice e import ekspert te mallrave te ndryshem industriale dhebujqesor.Transport kombetar dhe nderkombetar te mallrave per vehte dhe per te trete.Sherbime ne fushen e ndertimit si rikonstruksione e ndertime objekte social kulturore e banesa.

Kapitali themeltar I shoqerise eshte 100 000 leke ne pronesi te themeluesit te saj.

Selia e shoqerise eshte ne lagjen 30 vjetori Berat.

Administrator I shoqerise eshte zoti Haxhi Kreku.

Kohezgjatja e shoqerise eshte pa afat.


Kunder ketij vendimi lejohet ankim sipas ligjes.

G J Y Q T A R E

/ Marjana Dedi /



**AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"ALION"**




Sot me date 07.09.2003 une i nenshkruari Haxhi KRËKU, i lindur me 3.06.1972 ne Kapinove Berat, banues ne Lagjen " 30 Vjetori" Berat me shtetesi shqiptare me Pasaporte Nr.1561998, ne perputhje me ligjin Nr.7512 date 10.08.1991 "Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, te nismes se lire, te veprimtarise private pavarur dhe privatizimit", me ligjin Nr.7632 date 04.11.1992 "Per dispozitat qe rregullojne pjesen e pare te Kodit Tregtar", me ligjin Nr. 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" si dhe me aktet e tjera te legjislacionit ne fuqi, me cilesine e Ortaku te Vetem Themelues,

V E N D O S A

1. Te krijoje shoqerine tregtare "ALION" ne formen e nje shoqerie tregtare me pergjegjesi te kufizuar.
2. Emertimi i shoqerise eshte " ALION" Sh.P.K.
3. Selia zyrtare e shoqerise ndodhet ne qytetin e Beratit, Shqiperi.
4. Kohezgjatja e aktivitetit te shoqerise do te jete pa afat, duke filluar prej dates se rregjistrimit te saj ne Rregjistrin e Shoqerive Tregtare te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane.
5. Objekti i shoqerise eshte si me poshte:
 - Shfrytezimi e perpunimi i minerelave te grupit te katert sipas ligjit Minerar te Shqiperise si gur dekorativ, gur gelqeror, materiale inerte ndertimi etj.
 - Tregeti me shumice e pakice import-eksport mallra te ndryshem industrial e bujqesor.
 - Transport kombetar e nderkombetar i mallrave per vete e te trete.
 - Sherbime ne fushen e ndertimit si rikonstuksione e ndertime ndertime e objekte social kulturore, banesa etj.
 - Prodhimi dhe perpunimi i produkteve me karakter industrial e bujqesor import-eksport dhe pergjithesisht cdo operacion financiar, tregtar, industrial, me pasuri te luajteshme e te paluajteshme qe mund te lidhen drejtperdrejte ose terthorazi me nje nga objektet e shoqerise.
6. Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 (njqindmije) leke i ndare ne 100 (njqind) pjese kapitali te cilat kane vleren 1000 (njemije) leke secila, te gjitha te nenshkruara e te paguara nga Ortaku i Vetem themelues Z. Haxhi KRËKU.
7. Derdhja e kapitalit themeltar eshte bere ne masen dhe menyren e meposhteme:
Z. Haxhi KRËKU ka kontribuar teresisht ne para nepermjet depozitimit 100.000

(njqindmije) leke ne Degen e Bankes se Kursimeve Berat me date 05.09.2003, vertetuar me certifikaten e depozitimit leshuar nga kjo Banke.

- 
8. Pjeset e kapitalit jane te transferueshme ndaj te treteve sipas procedurave te parashikuara nga Ligji Nr. 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe nga statuti i shoqerise.
 9. Shoqeria do te administrohet nga nje amistrator. Administrator i pare i shoqerise eshte Ortaku i Vetem Z. Haxhi KRËKU. Ne rast se zgjerohet aktiviteti i shoqerise, si dhe ne rast se Ortaku i Vetem nuk deshiron ta ushtroje kete funksion ai merr vendim per emerimin e nje ose disa administatoreve te tjere. Ne kete rast emerimi do te behet me nje afat prej 3 (tre) vitesh f inanciare, me perjashtim te doreheqjes ose te shkarkimit te parakohshem. Administratori ne mardhenie me te tretet eshte perfaqesuesi ligjor i shoqerise. Ai ka te gjitha kopetencat per te kryer te gjitha veprimet e administrimit ne interes te shoqerise dhe qe jane ne perputhje me objektin e saj, me perjashtim te kompetencave qe ligji ja jep Ortakut te Vetem.
 10. Ndertimi, organizimi, dhe funksionimi i shoqerise rregullohet sipas dispozitave te legjislacionit shqiptar si dhe ne baze te statutit dhe ketij akti themelimi. Te gjitha kundershtimet ose mosmarrveshjet qe mund te lindin gjate funksionimit te shoqerise ose gjate likujdimit te saj midis ortakeve ose nje ose me shume ortakeve dhe Shoqerise do te diskutohen ne menyre te drjetperdrejte midis te interesuareve per ti zgjidhur miqesisht. Ne rast te kundert i nenshtrohen juridiksionit te gjykatave kompetente ne kushtet e parashikuara nga legjislacioni Shqiptar ne fuqi.

Ky Akt Themelimi eshte pergatitur ne kater ekzemplare ne gjuhen shqipe

Berat, me 07/09/2003

Haxhi KRËKU

Haxhi Krëku





REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERE ARBEN NDINO, BERAT

Nr 1285 - 357

VERTETIM

Sot, me 08.09.2003 para meje Noterit Arben Ndino ne Berat, u paraqit personalisht Z. Haxhi KRËKU, lindur ne Kapinove Berat me 03.06.1975, banues ne Berat, me numer pasaporte 1561998, ne cilesine e Ortakut te vetem themelues te Shoqerise "ALION" Sh.p.k (ne formim e siper), madhore, me zotesi te plote juridike per te vepruar, per identitetin e te cilit u sigurova pasi verifikova dokumentin e tij identifikuese. Ai nenshkroj lirisht para meje Noterit me vullnetin e tij te lire Aktin e mesiperm dhe une Noteri e vertetoj ate sipas ligjit.

NOTERE
Arben NDINO



STATUT
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“ALION” Sh.p.k

Une Haxhi KRËKU lindur më 03.06.1975 në Kapinove Berat me shtetësi shqipëtare banues ne Berat kamë hartuar statutin qe vijon te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar

KAPITULLI
EMËRTIMI, OBJEKTI, SELIA, KOHËZGJATJA

Neni 1- Forma

1. Shoqëria “ALION” Sh.p.k (më poshtë shënuar “shoqëria”) krijohet nga ortaku i vetëm themelues Haxhi KRËKU ne formën e një shoqerie tregtare me pergjegjesi të kufizuar qe rregullohet nga ligjet ne fuqi dhe nga ky statut.

Neni 2- Emërtimi

1. Emërtimi i shoqërisë është “ALION”. Në të gjitha aktet e dokumentet qe dalin nga shoqëria emërtimi i saj do te paraprihet (ose do te ndiqet menjëherë) nga inicialet “SH.P.K” dhe nga shpallja e kapitalit themeltar.

Neni 3-Objekti

Objekti i shoqërisë është si me poshte:

- Shfrytezimi e perpunimi i minerelave te grupit te katert sipas ligjit Minerar te Shqiperise si gur dekorativ, gur gelqeror, materiale inerte ndertimi etj.
- Tregeti me shumice e pakice import-eksport mallra te ndryshem industrial e bujqesor.
- Transport kombetar e nderkombetar i mallrave per vete e te trete.
- Sherbime ne fushen e ndertimit si rikonstuksione e ndertime objekte social kulturore, banesa etj.
- Prodhimi dhe perpunimi i produkteve me karakter industrial e bujqësor import-eksport dhe pergjithësisht cdo operacion financiar, tregtar, industrial, me pasuri te luajteshme e te paluajteshme qe mund te lidhen drejtperdrejtë ose terthorazi me një nga objektet e shoqërisë.

Neni 4- Selia

1. Selia zyrtare e shoqërisë ndodhet, ne qytetin Berat, Shqipëri.
2. Transferimi i selise së shoqërisë në një vënd tjeter mund të bëhet vetëm me vendim te Ortakut të Vetëm.



Ortaku i Vetëm mund te vendosë hapjen e filialeve, degëve, dhe përfaqësive të shoqërisë në qytete të tjera të Shqipërisë.

Neni 5-Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë do të jetë pa afat, duke filluar prej datës së regjistrimit të saj ne Rregjistrin e Shoqërive Tregtare të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

2. Shoqëria mund te shpërmdahet përpara këtij afati me vendim te Ortakut te Vetem.

Neni 6- Përgjegjesia

1. Shoqëria nuk përgjigjet për detyrimet e marra për qellime që nuk përputhen me ato te përcaktuara nga Statuti dhe Akti i Themelimit.
2. Shoqëria nuk përgjigjet për detyrimet e marra nga ortaku në emrin e tij personal ndaj personave fizikë, juridikë, privat ose publik, brënda ose jashtë shtetit.

K A P I T U L L I I I K O N T R I B U T E T, K A P I T A L I T H E M E L T A R

Neni 7- Kapitali Themeltar

1. Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 (njqindmije) lekë.
2. Kapitali themeltar është i përbërë nga 100(njqind) pjese kapitali, te cilat kane vlerën 1000 (njëmijë) lekë secila, të gjitha të nënshkruara dhe të paguara nga Ortaku i Vetem Z. Haxhi KREKU.

Neni 8-Kontributet ne kapitalin themeltar.


1. Derdhja e kapitalit themeltar eshte bere ne masen dhe meyrren e meposhteme:
Z. Haxhi KREKU ka kontribuar teresisht ne para nepermjet depozitimit 100.000 (njqindmije) leke ne Degen e Bankes Kursimeve Berat me date 05.09.2003 e vertetuar me certifikaten e depozitimit leshuar nga kjo Banke

Neni 9- Zmadhimi i Kapitalit Themeltar.

1. Kapitali themeltar mund te zmadhohet me vendim te Ortakut të Vetëm sipas modaliteteve dhe mënyrave te parashikuara ne nenet 62 dhe 63 te ligjit "Per shoqëritë tregtare".

Neni 10- Zvogëlimi i Kapitalit Themeltar

1. Me ane të një vendimi te Ortakut të Vetëm Shoqëria mund të zvogëloje kapitalin



themeltar sipas modaliteteve dhe mënyrave të parashikuara në nenin 64 të ligjit "Për shoqëritë tregtare". Në të gjitha rastet kapitali themeltar nuk mund të reduktohet nën kufijtë e parashikuar nga ligji.

Neni 11- Transferimi i pjesëve të kapitalit.

1. Pjesët e kapitalit mund tu transferohen të tereve, tërësisht ose pjesërisht, vetëm me vendim të Ortakut të Vetëm. Ato janë lirish të transferueshme në rrugë trashëgimie.

KAPITULLI III

VENDIMET, ADMINISTIRIMI, KONTROLLI

Neni 12- Marrja e vendimeve

1. Organi më i lartë vendimarrës është Ortaku i Vetëm i cili ushtron kompetencat që ligji parashikon për asamblene të ortakëve sipas parashikimeve të nenit 61 të ligjit "Për shoqëritë tregtare".

Neni 13- Administrimi

1. Shoqëria do të administrohet nga një administrator. Administrator i parë i shoqërisë është Ortaku i Vetëm Z.Haxhi KREKU.
2. Në rast se zgjerohet aktiviteti i shoqërisë, si dhe në rast se Ortaku i Vetëm nuk dëshiron ta ushtronte këtë funksion ai merr vendim për emerimin e një ose disa administratorëve të tjerë. Në këtë rast emërimi do të bëhet me një afat prej 3 (tre) vitesh financiarë, me përjashtim të dorëheqjes ose të shkarkimit të parakohshëm.
3. Administratori në mardhenie me të tretët është përfaqësuesi ligjor i shoqërisë. Ai ka të gjitha kompetencat për të kryer të gjitha veprimet e administrimit në interes të shoqërisë dhe që janë në përputhje me objektin e saj, me përjashtim të kompetencave që ligji ja jep Ortakut të Vetëm.

Neni 14 - Ekspertët Kontabël të Autorizuar.

1. Shoqëria do të kontrollohet (në rast se është e nevojshme) nga 1 (një) ose disa ekspertë kontabël të autorizuar të zgjedhur nga lista e Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar. Në caktimin e ekspertëve kontabël të autorizuar mbahen parasysh përjashtimet dhe papajtushmëritë e përcaktuara nga ligji "Për shoqëritë tregtare".
2. Eksperti/ët kontabël të autorizuar emërohen për një periudhë prej 6 (gjashtë) vitesh financiare me të drejtë rizgjedhje.

3. Detyrat dhe të drejtat e Ekspertëve Kontabël të Autorizuar të Shoqërisë janë ato të parashikuara nga ligji "Për shoqëritë tregtare". Raportet që ata përgatisin depozitohen në selinë e shoqërisë, në afatet e parashikuara nga ligji.

KAPITULLI IV VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPERNDARJA E FITIMEVE

Neni 15 - Viti financiar dhe bilanci vjetor.

1. Viti financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 dhjetor.
2. Viti i pare financiar fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë në Rregjistrin Tregtar të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe përfundon në 31 dhjetor të të njejtit vit.
3. Bilancet vjetore, inventari, raporti i Administratorit dhe i Ekspertit/ve Kontabël të Autorizuar (në rast se ka) miratohen nga Ortaku i vetëm.
4. Miratimi i dokumentave që lidhen me vitin financiar duhet të bëhet brënda 6 (gjashtë) muajve që nga fundi i vitit financiar.

Neni 16 – Rezultati i ushtrimit dhe percaktimi i Fitimit


1. Rezultati i ushtrimit percaktohet si diference ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve të ushtrimit. Nga fitimi i ushtrimit pakesuar kur është rasti me humbjet e meparshme, hiqet te pakten 5% (pese perqind) për të krijuar rezervën e domosdoshme. Heqja nga fitimi për rezervën e domosdoshme nuk është detyrueshme, kur kjo rezerve arrin 1/10 (nje të dhjeten) e kapitalit themeltar. Fitimi që rezulton pas zbitjes së rezervës ligjore dhe duke zbritur gjithashtu të gjitha shumatat që Ortaku i Vetëm dëshiron të lërë mënjanë në formën e rezervave të zakonshme ose të jashtëzakonshme, tërhiqet nga Ortaku i Vetëm.

KAPITULLI V

SHPERNDARJA DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE

Neni 17 - Prishja, Likujdimi

1. Përgjastuar rastin e një prishje me vendim gjyqi e parashikuar nga ligji, Shoqëria mund të priset në çdo kohë me vendim të Ortakut të Vetëm.
2. Përveç rastit të bashkimit ose të ndarjes prishja e shoqërisë për çfarëdo shkakut qofte sjell likujdimin e saj. Likujdimi kryet nga një ose disa likujdatore të emruar nga Ortaku i Vetëm, të cilët kryejnë këto detyra në përputhje me ligjin "Për shoqëritë tregtare"

- 
3. Likujdatori përfaqëson shoqerine. Ai ka kompetenca te plota per te shitur aktivet e shoqerise, per te shlyer kreditorët dhe per te shperndare mbetjen e disponushme ne favor te ortakut te vetem.
 4. Me perfundimin e procedures se likujdimit te Shoqerise, Ortaku i Vetem vendose, mbi bilancin financiar perfundimtar mbi vlefshmerine e punes se kryer nga likujduesi dhe mbi perfundimin e procesit te likujdimit.

Neni 18 -Transformimi i Shoqerise.

1. Shoqeria mund te shnderrohet ne nje forme tjeter vetem me miratim te Ortakut te Vetem.

Neni 19 - Shpenzimet.

1. Te gjitha shpenzimet, taksat dhe honoraret e paguara per kete akt dhe aktet qe rrjedhin prej tij i perkasin Ortakut te Vetem deri sa shoqeria te regjistrohet ne Rregjistrin Tregtar


Neni 20- Kundershtimet

1. Te gjitha kundershtimet gjate funksionimit te shoqerise ose gjate likujdimit te saj do te zgjidhen sipas rregullave te percaktuara ne statutun e shoqerise dhe legjislacionit ne fuqi. Kur mosmarrveshjet nuk zgjidhen ne mirekuptim ato i nenshtrohen juridiksionit te Gjykatave kopetente ne kushtet e parashikuara nga legjislacioni ne fuqi.

Neni 21- Dispozita te fundit

1. Per cfare nuk eshte shprehur ne kete statut rregullohet sipas legjislacionit ne fuqi per shoqerite tregtare.
2. Ky statut eshte pergatitur ne kater ekzemplare.

HAXHI KRËKU

Haxhi Krëku




REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERË ARBEN NDINO, BERAT
Nr 1258 - 357

VERTETIM

Sot, me 08.09.2025 para meje Noterit Arben Ndino ne Berat, u paraqit personalisht Z. Haxhi KRËKU, lindur ne Kapinove Berat me 03.06.1975, banues ne Berat, me numer pasaporte 1561998, ne cilesine e Ortakut te vetem themelues te Shoqerise "ALION" Sh.p.k (ne formim e siper), madhore, me zotesi te plote juridike per te vepruar, per identitetin e te cilit u sigurova pasi verifikova dokumentin e tij identifikuese. Ai nenshkroj lirisht para meje Noterit me vullnetin e tij te lire Statutin e mesiperm dhe une Noteri e vertetoj ate sipas ligjit.


NOTERË
Arben NDINO

URDHER REGJISTRIMI

30476

I	Nr. Regjistrimi
II	A. Emri "Alion, slyple. B. Selia Berat C. Objekti Shtypshirni i mineralere, treg import - eksport, procedur perpunim kolektor social kulturor etj. Ç. Kapitali 100.000 lek
III	Administrator Haschi Krelu.
IV	Kohzgjatja mbi 10 vjet Akt-Themelimi dt 08.09.2003. Statuti dt 08.09.2003.
V	Nenshtimi Depozitimi me D. B. K. Berat. Statuti 5 + 1M faqe Akt Themelimi 2 + 1M faqe

GJYQTARE



3 M deti -
27 TETOR 2003
27 10 2003

KERKESE



KERKUESI: Haxhi Kreku i biri i Aliut, l indur ne Kapinove Berat me dat 03.06.1975 dhe banues ne lagjen "30 Vjetori Berat.

OBJEKTI: Kerkese per rregjistrimin si person juridik te shoqerise tregtare "ALION" Sh.p.k.

Be regjistruar me nise Mania
27.10.03
28.10.03

PERPARA GJYKATES SE SHKALLES SE PARE TIRANE

Ne mbeshtetje te legjislacionit ne fuqi Haxhi Kreku ka krijuar si Ortak i Vetem shoqerine tregtare "ALION" Sh.p.k. Selia e shoqerise eshte ne Berat, l. 30 vjetori. Objekti i veprimtarise eshte:

- Shfrytezimi e perpunimi i minerelave te grupit te katert sipas ligjit Minerar te Shqiperise si gur dekorativ, gur gelqeror, materiale inerte ndertimi etj.
- Tregeti me shumice e pakice import-eksport mallra te ndryshem industrial e bujqesor.
- Transport kombetar e nderkombetar i mallrave per vete e te trete.
- Sherbime ne fushen e ndertimit si rikonstuksione e ndertime objekte social kulturore, banesa etj.
- Prodhimi dhe perpunimi i produkteve me karakter industrial e bujqesor import-eksport dhe pergjithesisht cdo operacion financiar, tregtar, industrial, me pasuri te luajteshme e te paluajteshme qe mund te lidhen drejtperdrejte ose terthorazi me nje nga objektet e shoqerise.

Nuk ke
[Signature]


Kapitali themeltar eshte 100.000 leke kontribut i Ortakut te Vetem themelues. Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise eshte pa afat. Administrator i shoqerise do te jete Ortaku i Vetem themelues Haxhi Kreku. Ne mbeshtetje te ligjit nr.7632 date 04.11.1992 "Per dispozitat qe rregullojne pjese e pare te Kodit Tregtar" dhe te ligjit nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" kerkoj rregjistrimin si person juridik te shoqerise tregtare "ALION" Sh.p.k.

Bashkangjitur kesaj kerkese ju paraqes:
-Aktin e themelmit,
-Statutin
-Certifikaten e depozitimit te fondeve ne Banken e Kursimeve Berat.

**KERKUESI
ADMINISTRATORI I SHOQERISE DHE ORTAKU VETEM THEMELUES I
"ALION" Sh.p.k.**

Berat, me 08.09. 2003

Haxhi KRËKU
Haxhi Kreku
[Signature]





REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERE ARBEN NDINO, BERAT
Nr 1285 - 35P

VERTETIM

Sot, me 08.09.2003, para meje Noterit Arben Ndino ne Berat, u paraqit personalisht Z. Haxhi KRËKU, lindur ne Kapinove Berat me 03.06.1975, banues ne Berat, me numer pasaporte 1561998, ne cilesine e Administratorit dhe Ortakut te vetem themelues te Shoqerise "ALION" Sh.p.k (ne formim e siper), madhore, me zotesi te plote juridike per te vepruar, per identitetin e te cilit u sigurova pasi verifikova dokumentin e tij identifikuese. Ai nenshkroj lirisht para meje Noterit me vullnetin e tij te lire Kerkesen e mesiperme dhe une Noteri e vertetoj ate sipas ligjit.

NOTERE
Arben NDINO

Arben Ndino
[Signature]

BANKA E KURSIMEVE SH.A
DEGA E BANKES KURSIMIT
Sektori i Pagesave

Berat me 25/09/2003

C E R T I F I K A T E

Me anen e kesaj çertifikate vertetojme se Z. *Florin Keku*
..... ka depozituar prane Deges Bankes Kursimit Berat
shumen prej *100.000*..... (*njëqinda mijë*.....) leke.

Ky depozitim behet per efekt te derdhjes (ngurtesimit) te
fondit te shoqerise " *ALION*..... " SH.P.K ne krijim e siper.

Dhurata DUNDO

D R E J T O R E

